




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-2452/13
Nr. f. faq. Broj stranica 02	Data Datum 20.08.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	20/08/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Agim ISLAMI u.d. Drejtor i Prokurimit në MPB
CC:	z. Driton GASHI Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin "Furnizimi me automjete për zjarrfikje dhe shpëtim"

I nderuar z. Islami,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me automjete për zjarrfikje dhe shpëtim", me nr. të prokurimit: 214 13 042 111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizimi me automjete për zjarrfikje dhe shpëtim" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion me ftesë të Autoritetit Kontraktues ka marrë pjesë në monitorimin e vlerësimit të Ofertave në MPB, për Tenderin “Furnizimi me automjete për zjarrfikje dhe shpëtim” me numër Prokurimi: 214 13 042 111 (05/08/2103 deri më 12/08/2013) dhe ka ardhur në përfundim se:

Në “Njoftim Kontrate” të publikuar në KRPP më datë 16/07/2013, tek pika III.2.4, tek rubrika “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika d) , thuhet se: Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve dhe superstrukturës në kohën e garancionit të dhënë nga tenderuesi fitues, minimumi 24 muaj, ndërsa tek specifikimet teknike në “Dosja e Tenderit” në faqen 81 kërkohet Garancion 5 vite pa kufizim të kilometrave. Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit duhet të jenë në harmoni të plotë në lidhje mes veti. Ky veprim nuk është në përputhshmëri me rregullat e prokurimit në Kosovë, ndërsa Komisioni vlerësues vlerësoi se kjo mospërputhje ishte lëshim teknik.

Specifikimet Teknike që duhet t’i përmbahen Operatorët Ekonomik, janë të specifikuara në atë mënyrë që i vë në lajthim Operatorët Ekonomik të interesuar.

OE “WEBO & FALCOM GROUP” i cili nga Komisioni Vlerësues u vlerësua si i pa përgjegjshëm, po ashtu i njëjti OE edhe në tenderin paraprak ishte shpallur i pa përgjegjshëm për të njëjtat kriteret. Ky veprim i këtij OE shton dyshimin se ka aplikuar vetëm për të plotësuar kriterin e aplikimit të së paku dy OE në një procedurë prokurimi.

Në “Dosja e Tenderit” të përpiluar nga Autoriteti Kontraktues është cekur se mbizotëron versioni i gjuhës Shqipe, gjatë monitorimit kemi hasur në elemente të cilat kanë qenë në përputhje me gjuhën Serbo-Kroate dhe Angleze, ndërsa jo edhe në gjuhën shqipe, si mbizotëruese në këtë rast. Kemi vënë re edhe disa gabime teknike në dosjen e tenderit, kemi hasur fjalë të gjuhës serbo – Kroate në dosjen e tenderit të gjuhës shqipe (tek specifikimet teknike - Faqe 84 në Dosje e Tenderit)

Konsiderojmë se një shkelje e tillë, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me nenin 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik; nenin 27 Dosja e Tenderit; dhe, nenin 28 Specifikimet Teknike, të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042.

Me respekt!